



Bashkia e Qytetit të Waterbury
Rregullorja e Programit Titulli VI

I.	TITULI VI DHE LIGJET NË LIDHJE ME DEKLARATËN E MOS DISKRIMINIMIT	1
II.	HYRJE	2
III.	NJOFTIMI I BASHKISË TË QYTETIT TË WATERBURY TITULLIT VI	3
IV.	SIGURIA E ZBATIMIT TË TITULLIT VI.....	5
V.	ORGANIZATA, PERSONELI & STRUKTURA	6
VI.	MBLEDHJA E TË DHËNAVE	7
VII.	ASISTENCA GJUHËSORE.....	8
VIII.	PROCEDURA E ANKIMIMIT TITULLI VI	9
	A. Formulari i Ankimit Titulli VI	10
IV.	RAPORTIMI I ZBATUESHMËRISE TË LIGJIT	14

I. TITULLI VI DEKLARATA E MOSDISKRIMINIMIT

Në përputhje me Kodin e Urdhëresave të Bashkise së Waterbury-t, Kapitulli 93, sipas Titullit VI të Aktit të të Drejtave Civile të vitit 1964 dhe statuteve të tjera të lidhura me të, bashkia duhet të marrë masat që asnjë person mos përjashtohet nga pjesëmarrja apo t'i mohohen përfitimet ose të diskriminohet për cdo program ose aktivitet që bashkia administron, në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, moshës, besimit fetar, paaftësisë, origjinës ose prejardhjes kombëtare, statusit martesor, statusit familjar, trajtimit paraprak psikiatrik, kujdesit shëndetësor, statusit ushtarak ose nga burimi i të ardhurave.



Me respekt Paul K. Pernerevski, Jr.
Kryetari i Bashkise së Qytetit të Waterbury

II. HYRJE

Bashkia e Waterbury është e perkushtuar të respektojë Titullin VI të Aktit të të Drejtave Civile të vitit 1964 ("Titulli VI"), i cili thotë:

"Asnjë person në Shtetet e Bashkuara, nuk do të përjashtohet nga pjesëmarrja, t'i mohohen përfitimet ose të diskriminohet nga raca, ngjyra ose origjina kombëtare në çdo program ose aktivitet që merr ndihmë financiare federale."

Si marrës i ndihmes federale financiare, Bashkia e Waterbury siguron që në përputhje me Titullin VI, Bashkia, punonjësit e saj, agjencitë, departamentet dhe nëndepartamentet të mos diskriminojnë në mënyrë të paligjshme gjatë kryerjes së biznesit të Bashkise. Qyteti kërkon që çdo menaxher, mbikëqyrës, punonjës, kontraktues dhe tjetër administrues i fondeve të ndihmës federale të jetë i vetëdijshëm dhe të zbatojë qëllimin e Titullit VI dhe ligjeve përkatëse në kryerjen e detyrave të caktuara.

Rregullorja e Programit të Titullit VI të Bashkise së Waterbury siguron udhezime të rregulloreve për të siguruar zbatueshmerine e Titullit VI të Aktit të të Drejtave Civile të vitit 1964.

III. NJOFTIM I BASHKISË E WATERBURY PËR TITULLIN VI

Bashkia Waterbury ka vënë në dispozicion njoftimin "Të drejtat tuaja sipas Titullit VI" për shikim publik dhe e ka paraqitur ne internet në www.waterburyct.org. Njoftimi është i disponueshëm në disa gjuhë.

Te Drejtat Tuaja Sipas Titullit VI

Çfarë është Titulli VI? Titulli VI është një dispozitë ligjore e Aktit të të Drejtave Civile të vitit 1964 ("Title VI"), i cili thotë:

"Asnjë person në Shtetet e Bashkuara, nuk duhet të përjashtohet, t'i mohohen përfitimet ose te diskriminohet për të marrë pjesë në ndonjë program ose aktivitet që merr ndihmë financiare federale."

Çfarë kuptoni me Titulli VI? Bashkia e Waterbury përpiqet të sigurojë që qasja dhe përdorimi i të gjitha programeve, shërbimeve ose përfitimeve që vijnë nga cdo aktivitet i qytetit do të administrohet pa marrë parasysh racën, ngjyrën ose origjinën kombëtare.

A ju janë shkelur të drejtat? Për të kërkuar më shumë informacion në lidhje me Titullin VI, ose nëse mendoni se jeni diskriminuar për shkak të racës, ngjyrës ose origjinës suaj kombëtare, mund të paraqisni një ankesë me shkrim brenda 180 ditëve nga diskriminimi i pretenduar në Koordinatorin e Titullit VI të Bashkisë së Waterbury. Formularin e ankesës do ta gjeni në internet në www.waterburyct.org. Ju mund të dërgoni ankesën tuaj me shkrim në email-in TitleVIcomplaint@NRWIB.org ose me postë në SHBA në adresën:

City of Waterbury Title VI Coordinator
Northwest Regional Workforce Investment Board
249 Thomaston Avenue
Waterbury, CT 06702

Ju gjithashtu mund të paraqisni një ankesë drejtpërdrejt me agjencinë që ofron ndihmë federale, ose duke paraqitur një ankesë në Departamentin e Drejtësisë të SHBA, Divizioni i të Drejtave Civile, 950 Pennsylvania Avenue, NW, Washington, D.C. 20530-0001.

IV. SIGURIA PËR ZBATIMIT E TITLE VI

Bashkia e Waterbury përfshin masat mbrojtëse për respektimin e Titullit VI në të gjitha kontratat dhe marrëveshjet të ndihmës federale. Këto garanci në thelb janë si më poshtë:

Kontraktuesi, nënkontraktorët dhe përgjegjësit duhet të zbatojnë masat e mëposhtme:

Kontraktori duhet të sigurojë si në momentin e tanishëm dhe në të ardhmen të jetë në përputhje me zbatimin e Titullit VI të Aktit të të Drejtave Civile të vitit 1964, i cili ndalon mos marrjen pjesë, mohimin e përfitimeve ose diskriminimin e çdo personi në Shtetet e Bashkuara në bazë të racës, ngjyrës ose origjinës (42 U.S.C. § 2000d et seq.), për programet dhe aktivitetet që marrin ndihme federale financiare, siç është përcaktuar në rregullore nga Departamenti i Thesarit Titulli VI në 31 CFR Pjesa 22 dhe nga urdhra të tjerë ekzekutivë si Urdhri ekzekutiv 13166, direktiva, pamflete, rregullore, memorandume dhe/ose dokumente udhëzuese.

Kontraktuesi pranon që Urdhri Ekzekutiv 13166, "Përmirësimi i aksesit për personat me kufizime të gjuhës angleze", synon të përmirësojë aksesin në programet dhe aktivitetet e asistuar nga qeveria për personat që, për shkak të origjinës së tyre kombëtare, kanë limitime të përdorimit të gjuhës angleze (LEP). Kontraktori e ka të qartë që mohimi i aksesit të një individi në programet, shërbimet dhe aktivitetet e tij për shkak të LEP-së është një formë e diskriminimit me origjinë kombëtare e ndaluar nga Titulli VI i Ligjit për të Drejtat Civile të vitit 1964 dhe rregulloret zbatuese të Departamentit të Thesarit. Për këtë arsye, kontraktori do të fillojë me masa të arsyeshme, ose për të qenë në përputhje me direktivat e Departamentit të Thesarit, dhe të sigurojë që individët e LEP-së të kenë akses kuptimplotë në programet, shërbimet dhe aktivitetet e tij. Kontraktori kupton dhe pranon që aksesit kuptimplotë përfshin ofrimin e shërbimeve të asistencës gjuhësore, duke përfshirë perkthimin me gojë dhe me shkrim kur është e nevojshme, për të siguruar një komunikim efektiv në programet, shërbimet dhe aktivitetet e Kontraktorit.

Kontraktuesi bie dakord të marrë parasysh nevojën për shërbime gjuhësore të LEP-së gjatë planifikimit të buxheteve të aplikueshme dhe zbatimit të programeve, shërbimeve dhe aktiviteteve. Si ndihme informative, Departamenti i Thesarit ka publikuar udhëzimet e tij për individët e LEP në 70 CFR 6067. Për më shumë informacion në lidhje me marrjen e hapave të arsyeshëm për të ofruar qasje kuptimplotë për individët e LEP, vizitoni <http://www.lep.gov>.

Kontraktori pranon dhe bie dakord që përmbushja e këtyre masave përbën një kusht të vazhdueshëm për marrjen e ndihmës financiare federale dhe është e detyrueshme për kontraktorin dhe pasardhësit e kontraktorit, transferuesve dhe të caktuarve me detyrë për periudhën në të cilën ofrohet kjo ndihmë.

V. ORGANIZIMI, STAFI & STRUKTURA

Koordinatori i Titullit VI të Bashkise së Waterbury është përgjegjës për zbatimin e përgjithshëm të programit të Titullit VI dhe luan një rol udhëheqës dhe pjesëmarrës në zhvillimin dhe zbatimin e pajtueshmërisë së Programit të Titullit VI.

Koordinatori i Titullit VI siguron zbatimin e programit të Titullit VI të qytetit të Waterbury. Pozicioni i koordinatorit të Titullit VI përfshihet në Bordin e Northwest Regional Workforce Investment

Koordinatori i Titullit VI është përgjegjës për të ndihmuar në zbatimin, monitorimin dhe raportimin mbi aktivitetet e programit të Titullit VI të bashkise për të përmbushur të gjitha kërkesat federale dhe shtetërore. Koordinatori i Titullit VI do të marrë një rol udhëheqës për të ndihmuar qytetin, të edukojë stafin e tij mbi përgjegjësitë dhe detyrimet e Titullit VI, duke siguruar që bashkia të përmbushë të gjitha kërkesat në lidhje me Titullin VI, duke përfshirë protokollin për ndihmën gjuhësore, dhe që Titulli VI të njoftojë dhe publikimet të shfaqen në publik ashtu si kërkohej.

Koordinatori i Titullit VI do të kontaktojë të gjitha departamentet e bashkise që marrin fonde federale ose administrojnë fondet financiare qeveritare për të marrë të dhëna demografike që departamentet ose agjencitë do të kenë, të cilat tregojnë se si pakicat e popullsisë së bashkise (sipas racës, ngjyrës dhe origjinës kombëtare) marrin shërbime nga programet dhe / ose shërbime të financuara nga qeveria federale. Koordinatori i Titullit VI do të publikojë një raport vjetor të Titullit VI, i cili do t'i ofrohet kryetarit të bashkise të qytetit të Waterbury, Këshilltarit të Përgjithshëm të Korporatës së qytetit të Waterbury dhe Zyrtarit Kryesor Financiar të qytetit të Waterbury, në të cilin do të raportojë mbi të dhënat demografike të mbledhura dhe do të përfshijë gjithashtu informacion mbi punën e kryer nga Koordinatori i Titullit VI në mbështetje të politikës së Titullit VI të bashkise dhe qëllimeve të përgjithshme të Titullit VI.

Përveç funksioneve të përshkruara të menaxhimit dhe pajtueshmërisë, Koordinatori i Titullit VI do të marrë pjesë gjithashtu në zbatimin e Titullit VI, siç parashikohet në politikën e Titullit VI të qytetit. Kjo do të përfshijë përpunimin, hetimin, dokumentimin dhe zgjidhjen e ankesave.

VI. GRUMBULLIMI I TË DHËNAVE

Bashkia e Waterbury do të mbledhë të dhëna statistikore (raca, ngjyra dhe origjina kombëtare) për pjesëmarrësit dhe përfituesit e projekteve të financuara nga qeveria.

VII. ASISTENCA GJUHËSORE

Një person me limitim në gjuhën angleze (LEP) është ai që nuk flet anglisht si gjuhën e tij amtare dhe nuk di mirë të flase, të shkruajë, të lexojë ose të kuptojë anglisht. Është politikë e Bashkisë të Waterbury që të sigurojë që individët me limitim të gjuhës angleze LEP të kenë akses të plotë në programet, shërbimet dhe aktivitetet e tij. Bashkia e është e vetdijshme që gjuha mund të jetë një pengesë për aksesin në përfitime ose shërbime të rëndësishme, për kuptimin dhe ushtrimin e të drejtave të rëndësishme, për respektimin e rregulloreve ose për të kuptuar informacione të tjera të ofruara nga programet dhe aktivitetet e tij.

Është politikë e bashkisë që të ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të siguruar akses kuptimplotë për individët përfitues që janë LEP duke marrë parasysh: (1) përqindjen e individëve të LEP në popullatën e kualifikuar për shërbim; (2) frekuenca me të cilën individët e LEP vijnë në kontakt me programin; (3) rëndësia e shërbimeve të ofruara nga programi; dhe (4) burimet në dispozicion të përfituesit. Një kopje e Njoftimit për Titullin VI dhe Formularit të Ankimimit Titulli VI janë vënë në dispozicion në disa gjuhë.

Nëse ka një nevojë të vazhdueshme për përkthim në një gjuhë tjetër, Bashkia do të marrë në konsideratë masat e duhura shpesh për të adresuar nevojat për qasje gjuhësore të atyre individëve.

VIII. PROCEDURA E ANKIMIMIT TITULLI VI

Çdo person që mendon se ai ose ajo i është nënshtruar një praktike diskriminuese të paligjshme sipas Titullit VI, ka të drejtë të paraqesë një ankesë zyrtare. Një ankesë e tillë duhet të dorëzohet me shkrim pranë koordinаторit të Titullit VI të City of Waterbury brenda 180 ditëve nga data e veprimit të pretenduar diskriminues. Formularët e ankimit janë në dispozicion në Waterbury City Hall dhe në internet në www.waterburyct.org.

Ankesat duhet të bëhet me shkrim dhe të dërgohet me postë në:

City of Waterbury Title VI Coordinator
Northwest Regional Workforce Investment Board
249 Thomaston Avenue
Waterbury, CT 06702

ose me email në: TitleVIcomplaint@NRWIB.org

Një mënyrë tjetër për të paraqitur një ankesë është të drejtohet drejtpërdrejt në agjencinë që ofron ndihmë federale, ose duke paraqitur një ankesë në departamentin e drejtësisë në U.S. Department of Justice, Civil Rights Division, 950 Pennsylvania Avenue, NW, Washington, D.C. 20530.

Brenda 10 ditëve biznesi nga marrja e ankesës, koordinatori i Titullit VI do të shqyrtojë ankesën për të përcaktuar nëse administrata e tij e ka në juridiksion. Ankuesi do të marrë një letër konfirmimi që informon nëse ankesa do të investigohet nga koordinatori i Titullit VI. Nëse brenda periudhës 10-ditore përcaktohet se koordinatori i Titullit VI e ka në juridiksion ankesën, koordinatori i Titullit VI do të ketë në dispozicion 30 ditë për të investiguar ankesën. Ankuesi do të njoftohet me shkrim nëse do të ketë ndonjë zgjatje mbi planifikimin e afatit 30-ditor.

Nëse nevojiten më shumë informacione për të zgjidhur rastin, koordinatori i Titullit VI mund të kontaktojë ankuesin. Ankuesi ka 10 ditë biznesi, nga data e letrës, për t'ia dërguar informacionin e kërkuar stafit investigativ të koordinаторit të Titullit VI, të cilit i është caktuar për ndjekur rastin. Nëse investiguesi nuk është takuar nga ankuesi ose nuk merr informacion shtesë brenda 10 ditëve të biznesit, koordinatori i Titullit VI mund t'a mbyllë çështjen administrativisht. Një çështje mund të mbyllet gjithashtu administrativisht nëse ankuesi nuk dëshiron më të ndiqet çështja e tij.

Pasi koordinatori i Titullit VI të shqyrtojë ankesën, koordinatori i Titullit VI do t'i dërgojë një nga dy letrat ankuesit: letër mbyllëse ose letren e gjetjeve (LOF). Letra përmbyllëse përmbledh akuzat dhe tregon se nuk ka pasur shkelje të Titullit VI dhe se çështja do të mbyllet. Letra LOF përmbledh pretendimet dhe intervistat në lidhje me incidentin e supozuar dhe shpjegon nëse do të merren masa disiplinore, trajnime shtesë të anëtarit të stafit ose masa të tjera.

A. Titulli VI Formulari i Ankesës

Titulli VI Formulari i Ankesës

Titulli VI është një dispozitë ligjore e Aktit të të Drejtave Civile të vitit 1964 ("Titulli VI"). Titulli VI kërkon që "Asnjë person në Shtetet e Bashkuara, në bazë të racës, ngjyrës ose origjinës kombëtare, të përjashtohet nga pjesëmarrja, t'i mohohen përfitimet ose do t'i nënshtrohet diskriminimit në ndonjë program ose aktivitet që merr ndihme financiare federale." 42 U.S.C. §2000d. Nëse besoni se jeni diskriminuar për shkak të racës, ngjyrës ose origjinës suaj kombëtare, mund të paraqisni një ankesë me shkrim brenda 180 ditëve nga diskriminimi i supozuar. Për ta bërë këtë, plotësoni këtë formular (bashkëngjitur janë disa faqe shtesë, nëse është e nevojshme) dhe dërgojeni me email në TitleVIcomplaint@NRWIB.org ose dërgojeni me postë në:

City of Waterbury Title VI Coordinator
Northwest Regional Workforce Investment Board
249 Thomaston Avenue
Waterbury, CT 06702

Shënim: Përdorimi i këtij formulari ankese nuk është i detyrueshëm. Ju mund të paraqisni ankesën tuaj në çdo formë që përfshin nënshkrimin tuaj.

Informacioni i Ankuesit:

Emri Mbiemri: _____
Adresa: _____
Telefoni: _____
Adresa e Email: _____

Informacioni i Avokatit:

Nëse përfaqësoheni nga një avokat, ju lutemi jepni informacionin e kontaktit të tij më poshtë.

Emri Mbiemri: _____
Adresa: _____
Telefoni: _____
Adresa e Email: _____

Lloji i Veprimeve Diskriminuese:

Ju lutemi plotësoni kutinë(te) që korrespondojnë me llojin(et) e diskriminimit që pretendoni se keni përjetuar.

- ☐ Raca
- ☐ Gjyra
- ☐ Origjina Kombetare

Data dhe vendndodhja e veprimeve të supozuara diskriminuese:

Përfshi datën më të hershme dhe më të fundit të diskriminimit të pretenduar.

Data

Vendodhja

--	--

Ne çfarë mënyre jeni diskriminuar?

Përkshkruan natyrën e veprimit, vendimit ose kushteve të diskriminimit të pretenduar.

--

Shpjegoni, sa më qartë që të jetë e mundur, çfarë ndodhi dhe pse besoni se statusi juaj i mbrojtur (lloji) ishte një faktor në diskriminim.

--

Përfshini mënyrën se si njerëzit e tjerë janë trajtuar ndryshe nga ju.

--

Emrat e personave (d.m.th., dëshmitarë, bashkëpunëtorë, mbikëqyrës ose të tjerë) me të cilët mund të kontaktojmë për informacion shtesë për të mbështetur ose sqaruar ankesën tuaj (përfshi informacionin e tyre të kontaktit):

Ligjet ndalojnë hakmarrjen ndaj çdo personi që ka ndermarre veprime ose ka marre pjese ne to për të siguruar të drejtat e mbrojtura nga këto ligje. Nëse mendoni se ka pasur hakmarrje (përveç diskriminimit të pretenduar më lart), ju lutemi shpjegoni rrethanat më poshtë. Shpjegoni se çfarë veprimesh keni ndërmarrë për të cilat besoni se ishin baza për akuzën.

Çfarë menyre ndreqje apo veprimi po kërkon për diskriminimin e pretenduar?

IV. RAPORTIMI I ZBATUESHMERISE SE LIGJIT

Koordinatori i Titullit VI, i cili është perfaqësues i Bashkisë së Waterbury do të kujdeset për të dhënat dhe do t'ja paraqesë zyrtarit përgjegjës qeveritar, shtetëror ose ndonjë eprori të tij, raportet e zbatimit të ligjit në mënyrë të kompletuar, të sakta dhe në kohë, në një formë të pershtatshme të përmbajtjes së informacionit, që organi përkatës mund të përcaktojë nëse është e nevojshme për t'i mundësuar asaj agjencie të konstatojë nëse është zbatuar në përputhje me ligjin kërkesa e marrësit. Koordinatori i Titullit VI në emër të qytetit të Waterbury do të vërë në dispozicion të agjencisë përkatëse të dhënat racore dhe etnike duke treguar shkallën në të cilën anëtarët e grupeve minoritare janë përfitues të programeve ndihmese qeveritare. Në rastin kur Bashkia i jep ndihmë financiare federale çdo marrësi tjetër ose ka kontratë me ndonjë person ose grup tjetër, Bashkia kërkon që ky marrës tjetër t'i paraqesë bashkisë raportet e zbatueshmërisë së ligjit siç mund të jetë e nevojshme për t'i mundësuar qytetit të përmbushë detyrimet e tij në raportimin e zbatimit të ligjit.

Koordinatori i Titullit VI si perfaqësues i Bashkisë do të lejojë një akses gjatë orarit normal të punës me libra, regjistrime, llogari dhe burime të tjera informacioni, si dhe në objektet e tij, që janë të rëndësishme për të verifikuar zbatueshmërinë e ligjit në përputhje me Titullin VI. Sa here që çdo informacion i kërkuar nga qyteti është në posedim ekskluziv të ndonjë agjencie, institucioni apo personi tjetër dhe ajo agjenci, institucion apo person dështon ose refuzon të japë atë informacion, marrësi duhet ta vërtetojë këtë në raportin e tij dhe të paraqesë përpjekjet që ka të kryera për të marrë këtë informacion.